

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.
013	1022
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data: Datum: Date:
3	24/04/2020
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, /Ministarstvo za Obrazovanje Nauku, Tehnologiju i Inovacije, /Ministry of Education Science, Technology and Innovation

Kabineti i Ministres/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

Ref:25/01B
Datë: 24.04.2020

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7 /01 mars 2019), nenit 5, paragrafi 1.3 dhe 1.4 dhe Neni 2, paragrafet 2.1, 2.2, dhe 2.4 të Ligjit (04/L-032) për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), dhe vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/07 të datës 11.03. 2020, nxjerr:

**Vendim
për**

Procedurat e realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë

1. Ky Vendim rregullon procedurat e vlerësimit të nxënësve në nivelin e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës gjatë periudhës së rrethanave emergjente të krijuara nga pandemia COVID 19.
2. Vlerësimi i nxënësve gjatë mësimit në distancë bazohet në parimet dhe metodat e përcaktuar me Udhëzuesin për Vlerësimin e Nxënësve gjatë Mësimit në Distance gjatë periudhës së rrethanave emergjente të krijuara nga pandemia COVID 19.
3. Vlerësimi i nxënësve gjatë mësimit në distancë realizohet i integruar. Ashtu që, gjatë periudhës së mësimit në distancë në rrethana të pandemisë COVID 19 nuk do të zbatohen dispozitat e nenit 3 të Udhëzimit Administrativ 8/2016 për Vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar në Republikës së Kosovës.
4. Nota përfundimtare e vitit mësimor/shkollor 2019/2020 në një fushë kurrikulare/lëndë mësimore nuk duhet të jetë më e ulët se ajo e datës 11 mars 2020, kur është ndërprerë mësimi i rregullt në shkollë për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19.
5. Nota përfundimtare në fund të vitit shkollor vendoset duke marrë parasyshë progresin e nxënësit dhe dëshmitë e mbledhura gjatë mësimit në distancë duke u siguruar që:

- 5.1. Mësimdhënësit gjatë gjithë kohës së mësimin në distancë sigurojnë, mbledhin dhe sistemojnë dëshmi për punën e nxënësve dhe suksesin e tyre.
 - 5.2. Dëshmitë e mbledhura për punën e nxënësve gjatë mësimin në distancë reflektohen në notën përfundimtare në fund të vitit mësimor/shkollor.
 - 5.3. Dëshmitë e mbledhura për punën e nxënësve gjatë mësimin në distancë ruhen në ditarin personal të mësimdhënësit për vlerësimin e nxënësve, sipas Udhëzuesit për vlerësim në distancë.
6. Në rast se nxënësi është i pakënaqur me notën përfundimtare, mësimdhënësi i fushës kurrikulare/lëndës mësimore përkatëse i mundëson atij/asaj t'i nënshtrohet një vlerësimi përfundimtar i cili përfshinë periudhën e mësimin në distancë dhe realizohet përmes njërës nga metodat standarde të vlerësimit:
 - 6.1. Testi me shkrim;
 - 6.2. Detyra përmbledhëse;
 - 6.3. Projekti hulumtues;
 - 6.4. Zgjidhja e problemeve;
 - 6.5. Provimi me gojë; dhe
 - 6.6. Prezantimi i nxënësit.
7. Metodatat e vlerësimit të nxënësve gjatë mësimin në distancë, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë janë të përshkruara në Udhëzuesin për Vlerësimin e Nxënësve gjatë Mësimin në Distancë.
 8. Nota përfundimtare e nxënësit evidencohet në ditarin personal të mësimdhënësit dhe raportohet në organet e shkollës, me qëllim të lëshimit të librezave, certifikatave, dëftesave e diplomave për nxënësit.
 9. Pas krijimit të kushteve për kthim në shkollë, notat përfundimtare vendosen në ditarin e klasës përkatëse dhe në librat amë, sipas procedurave të përcaktuara.
 10. Vlerësimi për shkallë kurrikulare për vitin shkollor 2019/2020 nuk realizohet.
 11. Vendimi për mbajtjen e Testit të arritshmërisë (klasa 9) dhe Provimit të Maturës (klasa 12), merret në muajin maj nga MASHTI, në konsultim me autoritetet dhe institucionet përkatëse. Me këtë vendim gjithashtu do të harmonizohen datat për regjistrim në klasën e 10-të si dhe afatet për aplikim për studime në Universitete apo Kolegje.
 12. MASHTI dhe institucionet edukative e arsimore ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që asnjë nxënësi i angazhuar aktivisht në mësimin në distancë të mos dëmtohet me rastin e kalimit nga një nivel në një nivel më të lartë arsimor.

13. Dispozitat e këtij Vendimi zbatohen vetëm për vitin shkollor 2019/2020 dhe iu përgjigjet nevojave dhe kërkesave të procesit të mësimit në distancë të kushtëzuara nga rrethanat e krijuara nga Pandemia COVID-19.
14. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen për vitin shkollor 2019/2020 edhe në rast të rifillimit të mësimit në objekte shkollore.
15. Deri sa të shfuqizohet pika 1.1 e dispozitivit të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/07 të datës 11.03.2020, pezullohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ 08/2016 për Vlerësimin e Nxënësve sipas Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës, të cilat bien ndesh me këtë Vendim dhe Udhëzuesin për Vlersimin e Nxënësve gjatë Mësimit në Distancë që rregullojnë përkohësisht vlerësimin e nxënësve në kushte të Pandemisë COVID-19.
16. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Udhëzuesi për Vlersimin e Nxënësve gjatë Mësimit në Distancë
17. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Hykmete Bajrami

Ministre në Detyrë



Vendimi I'u dërgohet

1. *Kabinetit të Ministres;*
2. *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
3. *DAK-vë;*
4. *Arkivit.*